



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenet 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040 dhe nenet 61 paragraf 1.6 dhe 64.3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE** **ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Neni 1

z.Bunjamin Hoti, me kualifikim- Master në shkencë juridike, nga fshati Bradash, Komuna e Podujevës, emërohet

- **Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik**

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet me mandat dhe kohëzgjatje në pajtim me shkesën e MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, përveç nëse me ndonjë vendim të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr.02-020/02-0041252/20
Podujevë,
03 gusht 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 4.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë nr. 04/L-050, sipas kërkesës së Agjencisë Kundër Korrupsionit nr. pro. 03-01/1626/20, datë 10.08.2020, për caktimin e zyrtarit kontaktues, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2, datë 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT KONTAKTUES**

Neni 1

Zyrtar kontaktues për deklarimin e pasurisë, n'kuadër të Komunës e Podujevës dhe për koordinimin e punëve me Agjencisë Kundër Korrupsionit, caktohet;

znj. Albertina Latifi, zyrtare e personelit në Zyrën e Personelit.

E-mail; albertina.latifi@rks-gov.net

Voip: 038 200 41-015

Tel mob.: 044/516-853

Neni 2

Detyrat kryesore të zyrtarit të caktuar sipas nenit 1 janë:

- Përcjell listën me emrat e zyrtarëve të lartë publik dhe njofton Agjencinë për ndryshimet në listë brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor;
- Njofton zyrtarët e lartë për deklarim të pasurisë;
- Regjistron dhuratat e pranuar nga personat zyrtar në regjistrin e institucionit dhe dorëzon kopjen e regjistrit tek Agjencia, deri më datë 31 mars të secilit vit kalendarik,

si dhe çështje tjera të parapara me ligjin përkatës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit


U dërgohet:

Të caktuarës

Agjencisë Kundër Korrupsionit

Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0045219/20
Podujevë, 12 gusht 2020



Nënkrjetari i Komunës
Nexhmj Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0032112/20, të publikuar më 29.06.2020,

në pajtim me shkresën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE TË FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Mbështeten 50 (pesëdhjetë) fermerë përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin "Linjë (Mullinjë) për prodhimin e ushqimit për kafshë", projekt në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Mbështetja e fermerëve bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të blegtorisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/01-0050282/20
Podujevë, 25 gusht 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0007661/20, dt. 31.01.2020, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR NDARJEN E SERRAVE FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Në kuadër të projektit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, “Përkrahja e fermerëve në projektin për ndarjen e serrave, në madhësi nga 100 m²”, ndahen edhe 15 (pesëmbëdhjetë) serra për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës.

Neni 2

Ndarja e serrave bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/01-0051788/20
Podujevë, 31 gusht 2020

